

**KOMISIONI EVROPIAN
KUNDËR RACIZMIT DHE INTOLERANCËS**

**REKOMANDIM N° 5
PËR POLITIKËN E PËRGJITHSHME I ECRI-T:**

**LUFTA KUNDER INTOLERANCES
DHE DISKRIMINIMEVE NDAJ MYSLIMANEVE**

MIRATUAR MË 16 MARS 2000

Strasbourg, 2000



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Secretariat of ECRI
Directorate General of Human Rights and Legal Affairs
Council of Europe
F - 67075 STRASBOURG Cedex
Tel.: +33 (0) 3 88 41 29 64
Fax: +33 (0) 3 88 41 39 87
E-mail: combat.racism@coe.int

Vizitoni ueb-saitin tonë: www.coe.int/ecri

Komisioni Evropian kundër racizmit dhe intolerancës:

Duke kujtuar Deklaratën e miratuar nga kryetarët e Shteteve dhe qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës gjatë samitit të tyre të parë, mbajtur në Vienë më 8-9 tetor 1993;

Duke kujtuar që Plani i veprimit për luftën kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës të përcaktuara sipas kësaj Deklarate, ka ftuar Komitetin e Ministrave të ngrejë Komisionin evropian kundër racizmit dhe intolerancës, i cili ka për mandat, mes të tjerash edhe formulimin e rekomandimeve të politikave bazë në qëllim të Shteteve anëtare;

Duke kujtuar gjithashtu Deklaratën përfundimtare dhe Planin e veprimit të miratuara nga kryetarët e Shteteve dhe të qeverive të Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës gjatë Samitit të tyre të dytë të mbajtur në Strasburg më 10-11 tetor 1997;

Duke nënvizuar se Deklarata përfundimtare verteton qëllimin e Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për të ndërtuar një shoqëri evropiane më të lirë, më tolerante dhe më të drejtë dhe bën thirrje gjithashtu për forcimin e luftës kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës;

Duke kujtuar se neni 9-të i Konventës evropiane të të Drejtave të Njeriut mbron të Drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë;

Duke kujtuar gjithashtu parimin e mos-diskriminimit, të cilin e përmban neni 14-të i Konventës evropiane të të Drejtave të Njeriut;

Duke marrë parasysh propozimet që Rekomandimi No 1162 përmban në lidhje me kontributin e kulturës islamike në kulturën evropiane, miratuar nga Asambleja parlamentare më 19 shtator 1991;

Duke patur përfundimet e seminarit mbi fenë dhe integrimin e emigrantëve, organizuar nga Komiteti evropian për emigracionin, mbajtur në Strasburg më 24-26 nëntor 1998;

Duke theksuar se Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës shfaqin diversitet në dipozitat e tyre institucionale, të cilat rregullojnë marrëdhëniet Shtet - fe;

Duke qenë të bindur se bashkëjetesa paqësore e feve në një shoqëri pluraliste është e bazuar mbi respektin dhe mbi mos-diskriminimin mes feve në një Shtet demokratik me një ndarje të qartë mes ligjit të shtetit dhe parimeve fetare;

Duke kujtuar se hebraizmi, kristianizmi dhe islamizmi janë influencuar nga njëri-tjetri dhe kanë influencuar gjatë shekujve qytetërimin evropian dhe duke kujtuar në këtë kontekst, kontributin pozitiv që sjell islamizmi në zhvillimin e shoqërive evropiane, ku është pjesë përbërëse;

I shqetësuar përballë disa shenjave të rritjes së intolerancës fetare ndaj islamizmit dhe komuniteteve myslimane në vendet ku kjo fe nuk është mazhorancë e popullsisë;

Me keqardhje të thellë që në disa raste gjëndet një imazh i deformuar i islamizmit, mbështetur në stereotipe armiqësore me qëllimin që t'i japin një pamje kërcënuese kësaj feje;

Duke refuzuar çdo lloj vizioni determinist të islamizmit dhe duke njohur diversitetin e brendshëm që e karakterizon praktikimin e kësaj feje;

Vendosmërisht të bindur për nevojën e luftës kundër paragjyqimeve nga të cilat vuajnë komunitetet myslimane dhe duke theksuar se këto paragjyqime mund të shfaqen në nivele të ndryshme, në mënyrë të vecantë nëpërmjet sjelljesh negative përgjithsisht, por gjithashtu, në shkallë të ndryshme, me diskriminime dhe dhunë e përndjekje;

Duke kujtuar që me gjithë shenjat e intolerancës fetare të përmendura më lart, një nga tiparet dalluese të Evropës sot është theksimi i diversitetit të besimeve në shoqëritë pluraliste;

Duke hedhur poshtë të gjitha shfaqjet e ekstremizmit fetar;

Duke theksuar që parimi i shoqërisë multirrefyetsore dhe multikulturore ecën i barabartë me dëshirën e feve për të bashkëjetuar në kushtet e shoqërisë ku ato bëjnë pjesë;

i rekomandon qeverive të Shteteve anëtare, kur komunitetet myslimane janë vendosur dhe jetojnë si minoritare në vendet e tyre:

- të sigurohen që komunitetet myslimane nuk diskriminohen, për sa i përket menyrës se si ato e organizojnë dhe praktikojnë fenë e tyre;
- të sanksionojnë në mënyrë të përshtatshme, në funksion të kushteve të vendit, diskriminimet e bazuara në fe;
- të marrin masat e nevojshme që të garantohet tërësisht liria e ushtrimit të fesë dhe në këtë kontekst t'i kushtojnë një vëmendje të vecantë heqjes së barrierave ligjore ose administrative që bëhen panevojë pengesë, si për ndërtimin e vendeve të kultit të përshtatshme dhe në numër të mjaftueshëm për praktikimin e fesë islamike, ashtu edhe për mbarëvajtjen e riteve funerale;
- të sigurohen që institucionet publike janë të sensibilizuara, në praktikën e tyre të përditshme, për nevojat legjitime kulturore dhe të atyre që rrjedhin nga karakteri multirrefyetsor i shoqërisë;
- të kontrollojnë nëse gjenden në praktikë diskriminime të bazuara tek feja, për sa i përket pranimin në qytetari, dhe në rast nevojë, të marrin masat e duhura për t'i dhënë fund;
- të marrin masat e nevojshme për të hequr çdo lloj shfaqje diskriminimi në lidhje me pranimin në arsimimin e bazuar në motive besimi fetar;
- të marrin masat, nëse është e nevojshme në planin legjislativ, për të luftuar diskriminimin me motiv fenë, në lidhje me pranimin në punësim dhe integrimin në jetën e punës;
- të inkurajojnë punëdhënësit të parashtrojnë dhe të venë në zbatim "kodet e sjelljes së mirë" për të luftuar diskriminimin me motiv fenë, për sa i përket integritet në punësim dhe në jetën e punës, si dhe, në rast nevojë, të hapin vende pune që përfaqësojnë diversitetin e shoqërisë në fjalë;

- të vlerësojnë nëse pjestarët e komunitetit mysliman diskriminohen në aspektin e perjashtimeve nga shoqëria, dhe në rast nevojë, të marrin të gjitha masat e duhura për të luftuar këto fenomene;
- t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë situatës së grave myslimane, duke qenë se ato mund të vuajnë njëkohësisht diskriminime në raport me gratë në përgjithësi dhe diskriminime nga myslimanët;
- të kujdesen që programet nëpër shkolla dhe në mësimdhënien e lartë - veçanërisht në lëndën e historisë- të mos paraqesin interpretime të shtrembëruara të historisë së feve dhe kulturave dhe të mos bazojnë vizionin për islamizmin në perceptime armiqësie dhe kërcënimi;
- të kujdesen që mësimdhënia e feve në shkollë të respektojë pluralizmin kulturor dhe të sigurojë formimin e mësuesve për këtë qëllim;
- të shkëmbejnë me komunitetet myslimane lokale pikpamje në lidhje me mënyrat e lehtësimit të zgjedhjes dhe formimit të hoxhallarëve duke njohur shoqërinë në të cilën ata do të punojnë dhe duke patur, nëse është e mundur, një lloj eksperience;
- të inkurajojnë dialogun vullnetar në nivelet lokale dhe kombëtare për të sensibilizuar popullsinë në pikat ku duhet kushtuar një vëmendje e veçantë, me qëllim që të shmagen konfliktet sociale dhe kulturore;
- të inkurajojnë reflektimin tek profesionet e lidhura me fushën e komunikimit, veçanërisht tek ato të sektorit të mediave dhe të reklamës, lidhur me imazhin e islamizmit dhe të komuniteteve myslimane të pasqyruara nga këto të fundit dhe përgjegjësinë që bjen mbi profesionistët e këtyre sektorëve që të mos paragjykojnë dhe të mos mbajnë anë në paraqitjen e informacionit;
- të sigurojnë ndjekjen dhe vlerësimin e efikasitetit të çdo lloj mase, e marrë me qëllimin për të luftuar intolerancën dhe diskriminimin ndaj myslimanëve;

